




Reforma e Sistemit Pensional

Fondi për Sigurime Sociale



Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është një think-tank i pavarur, jofitimprurës, i përqendruar në kërkime dhe analiza empirike të zhvillimit socio-ekonomik në Kosovë. IKS u krijua në 2004 në njohjen e nevojës së ngutshme për analiza të pavarura dhe të thelluara të çështjeve të rëndësishme të përfshira në promovimin e stabilitetit dhe prosperitetit në Kosovë. Hulumtimi inovativ rreth politikave synon të nisë debate mbi çështje të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë se debati publik i bazuar në dëshmi/fakte qëndron në thelbin e vendimmarrjes demokratike dhe transformimit ekonomik në vend. IKS nuk ka përkatësi partiake, politike apo lidhje me ndonjë organizatë tjetër.

Ekipi me përvojë dhe shumë-disiplinar i IKS-it është i përkushtuar në arritjen e objektivave të organizatës. Një Bord Këshillëdhënës, përfshirë analistët dhe praktikuesit kosovarë dhe ndërkombëtarë, gjithashtu mbështesin punën e saj.

Që në ditët e para, IKS ka punuar në projekte të shumta kërkimore empirike që përqendrohen në tema socio-ekonomike, si sigurimet shoqërore dhe marrëdhëniet e punës, qeverisja, zhvillimi ekonomik, trashëgimia kulturore, korrupsioni në

rindërtimin e pasluftës, çështjet mjedisore, edukimi, problemi i imazhit të Kosovës dhe struktura aktuale e ngatërruar e qeverisjes.

IKS është gjithashtu pjesë e një rrjeti të think-tank-ve të inicuar nga ESI në të gjithë Evropën Juglindore dhe anëtar i asociuar i ECAS.

Për më shumë raporte të ngjashme vizitoni faqen tonë të internetit, Iniciativa e Kosovës për Stabilitet: www.iksweb.org. Vizitoni faqen tone në [Facebook](#), ose na kontaktoni direkt me kërkesat tuaja përmes postës elektronike info@iksweb.org

Përmbajtja

SISTEMI I MBROJTJES SOCIALE	1
LLOJET EKZISTUESE TE PERFITIMEVE	4
SKEMA E NDIHMES SOCIALE.....	5
SHTESA PËR AFTËSIN E KUFIZUAR.....	5
INVALIDËT E LUFTES.....	5
GRUPET VULNERABEL NE RREZIK TE VARFERISE.....	6
SISTEMI I PENSIONEVE	6
HENDEKU GJINOR	9
KERKESAT DHE ZGJIDHJA	12
REFORMA E SISTEMIT PENSIONAL – FONDI	13
SIGURIME SOCIALE:	14
SITUATA AKTUALE:.....	15
OBJEKTIVA E REFORMËS:	16
SI DO TË DUKET REFORMA:.....	17
CKA ËSHTË FONDI PËR SIGURIME SOCIALE?	17
PSE DUHET?.....	18
SA JANË SHPENZIMET AKTUALE TË SKEMAVE PENSIONALE?	18
SA JANË SHPENZIMET PËR ZBATIMIN E REFORMËS?	19
SI E KANË TË RREGULLUAR SHTETET E TJERA?	19
PËRFUNDIM.....	19

SISTEMI I MBROJTJES SOCIALE

Gjersa popullsia e Evropës po vjetërsohet, popullsia në Kosovë vazhdon të rritet, megjithëse me ritme më të ulëta në dekadën e fundit. Pavarësisht ritmit më të ulët, popullsia është e re, madje, pothuajse gjysma e popullsisë është nën 25 vjeç, ndërsa raporti i varësisë është 32,29% (raporti i varësisë, i shprehur në përqindje, llogarit pjesën e popullsisë nga 0 deri në 14 vjeç dhe mbi 65 vjeç, krahasuar me popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç).

Pak vende kanë përjetuar ndryshime kaq dramatike në sistemet e tyre të mbrojtjes sociale sesa Kosova. Nga viti 1974 deri në vitin 1989, Kosova realizonte sistemin e saj të mbrojtjes sociale si një krahinë autonome, me legjislacion të përafuar me atë të Federatës Jugosllave. Pavarësisht se ishte krahina më e varfër dhe më pak e zhvilluar e Federatës, Kosova ishte pjesë e mirëqenies shtetërore jugosllave që bazohej në një përzierje të përfitimeve të bazuara në sigurime, mirëqenies në vendin e punës, qendrave për punë sociale që ofronin shërbime profesionale të punës sociale dhe ndihmë të kufizuar sociale për familjet e varfra. Me suprimimin e statusit të Kosovës si krahinë autonome, në mars 1989, të drejtat përfituese të Kosovës u integruan drejtpërdrejt në sistemin e mbrojtjes sociale të Serbisë. Në vitet 1990-1991 shumica e shqiptarëve të Kosovës u larguan nga punët e tyre në sektorin publik (që në atë kohë ishte pothuajse i vetmi punëdhënës) dhe me vendin e punës ata humbën të drejtën e përfitimit në bazë të papunësisë dhe pushuan së kontribuuari në fondet pensionale. Nga shtatori i vitit 1990, shqiptarët vendosën një regjim paralel që krijoi në mënyrë efektive rrjetin e asistencës sociale dhe të shërbimeve sociale, të bazuar në vetëndihmë të drejtuar nga shoqëria civile.

Pas luftës, Kosova ka përjetuar rritje ekonomike solide edhe pse të pamjaftueshme. Vlerësohet se norma vjetore e rritjes së PBB-së është 3.5 për qind me një kërkesë të fortë të brendshme që po zgjerohet me rreth 6 për qind. Megjithatë, Kosova ka një nga Bruto Produktet Vendore (BPV) më të ulëta për njeri në Evropë dhe renditet në mesin e ekonomive me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ekonomia e saj është ende e brishtë dhe mbështetet shumë në remitancat që përbëjnë 11 për qind të BPV-së. 29.7% e popullsisë së Kosovës jetojnë nën kufirin e varfërisë absolute, ndërsa 10.2 për qind jetojnë nën kufirin e varfërisë ekstreme. Përveç mungesës së vendeve të punës, Kosova vuan nga papunësia strukturore (aftësitë teknike që mësohen nuk përputhen me kërkesat e tregut të punës) që kontribuojnë në këtë situatë të zymtë ekonomike.

Shkalla e lartë e papunësisë dhe niveli i lartë i informalitetit në sektorin privat, identifikohen si pengesa direkte për dialogun social, por gjithashtu si shkaktarë kryesorë, sipas vëzhgimit dhe

të dokumentimeve, si pengese paraqitet edhe sjellja joparimore e punëdhënësve ndaj punonjësve të tyre. Përderisa të drejtat e punëtorëve të sektorit publik mbrohen në masë të madhe nga legjislacioni dhe mekanizmat ekzistues, duke përfshirë organizimin në sindikata, studimet e fundit të IKS-it, kanë gjetur se "skllavëria moderne" është termi adekuat që përshkruan kushtet e punës në një pjesë të madhe të ekonomisë. Ndonëse çdo kompani që ka të punesuar mbi 50 punëtor, është e detyruar me ligj të lejojë punëtorët të **organizohen** në sindikata, prania e tyre në sektorin privat është shumë e pakët dhe kryesisht joefektive.

Qeveria e Kosovës, përmes politikave adekuate sociale, e ka prioritetizuar rritjen e vendeve të punës përmes punësimit të denjë. Fatkeqësisht, Agjenda e Reformës Evropiane dhe Programi i Reformës Ekonomike të BE-së, i kanë vënë më shumë theks punësimit dhe rritjes së punësimit, duke dështuar në identifikimin e mënyrave se të sigurohet që këto synime të mos cenojnë të drejtat e punës së denjë dhe mbrojtjen sociale dinjitoze për shoqërinë kosovare.

Nga fundi i luftës në Kosovë, prej vitit 1999 deri në vitin 2008, agjenda zhvillimore e Kosovës me të drejtë dominohej nga agjenda politike. Megjithatë, që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, nuk ka asnjë justifikim për sistemin e ngjeshur të mbrojtjes sociale, që është krijuar për të akomoduar grupet sociale më me ndikim, sesa ato më në nevojë. Kjo ka rezultuar në marginalizimin e mëtejshëm të disa prej grupeve tradicionalisht të cenueshme (për shembull, gratë, fëmijët dhe të moshuarit). Sistemi është gjithashtu i prirur ndaj diskriminimit brenda të njëjtit grup (për shembull, personat me aftësi të kufizuara të lidhur me luftën marrin mesatarisht 6 herë më shumë të ardhura nga skemat shtetëror, e sesa ata me aftësi të kufizuara pa ndonjë lidhje me luftën).

LLOJET EKZISTUESE TË PËRFITIMEVE

Si një sistem i krijuar nga e para në kohën e UNMIK-ut, Kosova ka një numër të kufizuar të përfitimeve të mbrojtjes sociale. Nuk ka përfitime nga papunësia, nuk ka ende kompensim adekuat për lehoninë të bazuar në ligj dhe as skemë të garantuar të përfitimeve të fëmijëve, edhe pse ekziston një skemë bazë e ndihmës sociale që është krijuar gjithashtu nga UNMIK-u.

SKEMA E NDIHMËS SOCIALE

Edhe pse e projektuar në vitin 1999 për të shërbyer si një mjet emergjent për zbutjen e varfërisë dhe e prezantuar në vitin 2000, skema u ndryshua shumë pak nga Ligji për Ndihmën Sociale në 2003 (Ligji 2003/13). E financuar plotësisht nga buxheti i përgjithshëm, ajo është krijuar për të mbështetur familjet e gjera (të përcaktuara si jo më shumë se dy breza që jetojnë në të njëjtën amviseri). Ai i ndan familjet në Kategorinë I dhe II, ku Kategoria I janë familje pa asnjë person të aftë për punë dhe/ose familje ku i vetmi person i aftë për punë kujdeset për një person të paaftë fizikisht (mbi 65 vjeç), që nuk ka të ardhura dhe jo më shumë se gjysmë hektar tokë. Përfituesit e kategorisë së II përfshijnë familjet ku anëtarët e aftë për punë janë të regjistruar si të papunë dhe që kanë një fëmijë nën moshën 5 vjeç, ose ofrojnë kujdes të plotë për një jetim. Nivelet e përfitimeve janë të pamjaftueshme, me vetëm një të tretën e kuintilit të poshtëm që merr përfitime në para, dhe me nivele përfitimesh të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat bazë në rastin e shumicës së llojeve të familjeve. (FMN, 2016)

SHTESA PËR AFTËSIN E KUFIZUAR

Kjo skemë u prezantua në vitin 2004 si rezultat i Ligjit për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar në vitin 2003 (Ligji 2003/23), pas një vlerësimi të kujdesshëm me konsulentët ndërkombëtarë duke vendosur kritere për të minimizuar abuzimin ose mashtrimin e mundshëm. Skema lejon një kompensim për aftësinë e kufizuar, në rast të paaftësisë së vërtetuar 100%, të përcaktuar si paaftësi të plotë dhe të përhershme dhe mungesë aftësie për të punuar. Kompensimi paguhet për të rriturit që janë rezidentë të përhershëm në një shumë prej 75 € në muaj.

INVALIDËT E LUFTËS DHE PËRFITIMET E TË AFËRMVE TË TYRE

Kjo skemë filloi në vitin 2001 dhe aktualisht rregullohet me ligj të vitit 2006. Përfitimi u paguhet katër grupeve të ndryshme të përfituesve:

- a) invalidëve si pasojë e veprimtarisë ushtarake;
- b) viktimave civile të luftës dhe familjeve të luftëtarëve të vrarë;
- c) familjeve të personave të zhdukur;
- d) kujdestarëve të personave të paaftë si pasojë e luftës.

Shuma e përfitimit ndryshon në bazë të kategorisë, nivelit të invaliditetit dhe numrit të **vartësve**. Përshtatshmëria për pensione të invalidëve të luftës kushtëzohet nga një nivel invaliditeti mbi 20 për qind. Ky kriter vlerësohet si shumëfish më i favorshëm se me kushti për 100 për qind paaftësi, që kërkohet për përfitimin e paaftësisë së skemes së sigurimeve shoqërore. Për më tepër, pensioni më i ulët për invalidët të luftës së UÇK-së që me 20 për qind invaliditet, është tre herë më i lartë se pensioni normal i invaliditetit. Skema është kritikuar nga Banka Botërore dhe FMN si jotransparente dhe që shkakton diskriminim midis grupeve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

GRUPET VULNERABËL NË RREZIK TË VARFËISË DHE PËRJASHTIMIT

Vlerësimi më i fundit i Bankës Botërore për shkaqet e varfërisë, zbulon se varfëria bazohet në katër faktorë të mëdhenj:

- a) Madhësia dhe përbërja e familjes (familje më të mëdha, me 6 ose më shumë anëtarë, familje në varësi, familje me kryefamiljare femra);
- b) Përkatësia etnike, (romët në zonat me shumicë serbe);
- c) Marrëdhëniet me tregun e punës (të papunët, të varfërit që punojnë në Kosovë, kryesisht punëtorët e paguar në baza ditore, të vetëpunësuarit dhe ata në sektorin e minierave, punëtorët e vetëpunësuar në bujqësi, familjet me migrantë dhe pranues të remitancave);
- d) Niveli i arsimimit (njerëzit që nuk kanë përfunduar arsimin fillor, ata me arsim fillor dhe të mesëm, fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 24 vjeç, kanë gjasa joproporcionale të jetojnë në varfëri dhe varfëri ekstreme).

SISTEMI I PENSIONEVE

Për momentin, sistemi pensional i Kosovës është ndërtuar rreth tri shtyllave, ku e treta nuk është relevante duke qenë se nuk është e shfrytëzuar dhe është plotësisht vullnetare:

Shtylla I - Skema e Pensionit Bazë

Pensioni bazë është një sistem linear dhe vlen për të gjithë personat më të vjetër se 65 vjeç që banojnë kryesisht në Kosovë. Ky pension u jepet të gjithëve që plotësojnë kriteret e moshës dhe nuk kanë lidhje me punën. Përfitimi mujor në para nga kjo skemë pensionale në vitin 2002 ishte 28 euro, 35 euro në vitin 2003 dhe mbeti 40 euro nga viti 2004 deri në vitin 2008. Nga **viti 2019 nga shuma 75 euro, pensioni është ritur në 90 euro**. Deri në muajin mars të vitit 2021, 142, 092 persona kanë qenë përfitues të pensioneve bazë.

Derisa ka pak më shumë se shporta e ushqimeve, një person që jeton vetëm me këtë pension bazë ndoshta do ta ketë shumë të vështirë të jetojë i pavarur dhe kështu do të duhet të mbështetet tek anëtarët e familjes. (Mos e ngjit atë që nuk është thyer - 2016)

Për ata që kanë kontribuar në sistemin pensional të Republikës së Serbisë para konfliktit, pensioni shtesë është zbatuar që nga viti 2008. Pensioni mujor ishte 35 euro dhe do të paguhej përveç pensionit bazë të moshës, nëse në sistemin e mëparshëm evidentohen të paktën 15 vjet kontribut. Sipas Departamentit të Administrimit të Pensioneve (PAD), rreth 28,135 pensionistë - ose rreth 20% e të gjithë pensionistëve mbi 65 vjeç – kanë perfituar pensione që nga janari 2009. **Nese nuk ndryshon si kusht, numri i perfituesve pritet të zvogelohet në të ardhmen.**

Shtylla 2 - Kursimet Pensionale Individuale (të Detyrueshme)

Sistemi i kursimeve pensionale të detyrueshme parashikon pensione mbi pensionin bazë, i cili mbulon punonjësit dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë mbi 18 vjeç. Kjo është e detyrueshme për personat e lindur pas vitit 1946, ndërsa për ata që kanë lindur para atij viti, kontributi lihej në baza vullnetare. Çdo punëdhënës është i detyruar të mbajë në burim kontributet e kursimeve pensionale për punonjësin e tij në masën 10% të pagës bruto të punonjësit, e cila ndahet nga punëdhënësi (5% e pagës bruto) dhe punonjësi (5% paga bruto) - megjithëse mund të zgjedhë të paguajë një maksimumi 15% (Shtylla III e Pensioneve Vullnetare). Regjistrimet e këtyre transaksioneve menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), i cili angazhohet në investime jashtë vendit përmes shkembimeve me menaxherët kryesorë evropianë të aseteve. Fondet e huaja dhe investimet e brendshme nuk janë nën juridiksionin vendor ligjor; megjithatë, ekzistojnë standarde të larta për sigurinë.

Shtylla 3 - Pensioni vullnetar individual ose punëdhënës

Sistemi i pensioneve vullnetare organizohet **në nivel të kompanive siguruese**, si fond pensioni suplementar i punëdhënësit ose në baza individuale si pension individual suplementar. Banka Qendrore e Kosovës rregullon dhe mbikëqyr kompanitë private që ofrojnë sigurime pensionale vullnetare.

Decentralizimi i shërbimeve sociale

Deri në vitin 2009 ofrimi i shërbimeve sociale është bërë nga ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), aktualisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS). Decentralizimi i shërbimeve sociale nga niveli qendror në komuna u bë prioritet që nga viti 2009 me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet ish MPMS-së, komunave përkatëse, ish-Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Megjithatë, ky proces nuk është i lidhur në mënyrë sinkrone me planifikimin buxhetor sipas dispozitave të Ligjit për financat e pushtetit lokal, të cilat përcaktojnë procedurat për delegimin e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal. Për shkak të kësaj, ekziston një mungesë e qartësisë midis komunave për buxhetin në dispozicion për shërbimet sociale, gjë që ka rezultuar në ndryshime të konsiderueshme në nivelet e mbështetjes për ofrimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu, komunat nuk kanë të dhëna të sakta për numrin e popullsisë, e lëre më që të dhënat të ndahen sipas gjinisë, grupmoshave, përkatësisë etnike, cënueshmërisë etj., gjë që ndikon negativisht në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve. Më poshtë janë disa nga sfidat që lidhen me zbatimin e decentralizimit:

- Sfidat e financimit për ofrimin e shërbimeve sociale nga QPS-të.
- Mungesa e një formule specifike financiare për shërbimet sociale.
- Bashkëpunim i kufizuar dhe planifikim buxhetor në komuna
- Mungesa e të dhënave statistikore të bazuara në planifikimin komunal për grupet më të cënueshme.
- Kapacitete të pamjaftueshme të QPS-ve.
- Qëndrueshmëri e kufizuar financiare e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale.

Decentralizimi si parim i qeverisjes lokale në Kosovë u përdor më tepër si një mënyrë për të garantuar mbrojtjen sociale për grupet e cënueshme, veçanërisht pakicat etnike. E shtyrë nga imperivat politike, Kosova miratoi Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL, 2008) dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare (LSFS, 2005), të cilat përbëjnë bazën ligjore për ofrimin e shërbimeve sociale në vend. Megjithatë, që decentralizimi të jetë efektiv, duhet të ndodhë transferimi i fondeve për shërbimet sociale ndërmjet MFLT-së dhe komunave dhe duhet të krijohet infrastruktura për shërbimet e decentralizuara. Këto zhvillime të pabarabarta ligjore, fiskale dhe infrastrukturore kanë çuar në ofrim të pabarabartë të shërbimeve, duke rezultuar në pasoja negative për grupet vulnerabël dhe perceptime negative për decentralizimin si të tillë.

Sfidat kryesore të sektorit

Përfitimet dhe pensionet e lidhura me luftën për grupet e favorizuara gëlltitën pothuajse të gjitha rritjet në shpenzimet e mbrojtjes sociale midis 2008 dhe 2012.

Përfitimet e lidhura me luftën paguhen pavarësisht nga mosha ose aftësia e përfituesit për të punuar, megjithëse disa janë të lidhura me aftësinë e kufizuar. Familjet e veteranëve të vdekur dhe të zhdukur marrin përfitime më shumë se 25 për qind mbi pagën mesatare, e matur në 457 euro për pension kundrejt 365 euro pagë mesatare, duke i lënë ata me një nxitje të ulët për të marrë pjesë në tregun e punës. Në vende të tjera politika të tilla kanë çuar në informalitet më të lartë, pjesëmarrje më të ulët të fuqisë punëtore duke dëmtuar potencialin afatgjatë të rritjes së ekonomisë, si dhe në ngushtimin e përfitimeve civile mbi bazën tatimore.

Mungesa e mbrojtjes sociale dhe fondi

Deri më sot nuk ka pasur vullnet politik për hartimin e një fondi të mbrojtjes sociale, e lëre më ndonjë iniciativë për krijimin e tyre. Megjithatë, qeveria e re po kupton çdo ditë e më shumë se mungesa e fondeve, po rezulton të jetë një sfidë në rritje për procesin e hartimit të politikave sociale të lidhura me punën, si p.sh. leja prindërore apo pushimi mjekësor afatgjatë. Për më tepër, presionet në rritje në buxhetin e Kosovës nga grupe të ndryshme të cënueshme dhe presionet për përfshirje më të madhe dhe barazi të shpërndarjes, krijimi i fondit të mbrojtjes sociale është bërë i vetmi veprim korigjues për shoqërinë kosovare. Për krijimin e fondeve të sigurimeve shoqërore nuk janë projektuar dhe nuk janë ndërmarrë ende nisma ligjore. Për më tepër, ende nuk kemi zbatim të Ligjit për sigurim shendetësor, pikerisht për shkak të mos krijimit të fondit. Mungesa e tyre po rezulton të jetë një sfidë në rritje kur hartohen politika sociale të lidhura si p.sh. leja prindërore, mbrojtja bazë nga papunësia ose leja mjekësore afatgjatë.

Ligji për sigurimin e të drejtave të sigurimeve shoqërore është miratuar në vitin 2014, Ligji nr.04/L — 131 për skemat e pensioneve të financuara. Edhe pse i miratuar në vitin 2014, ky ligj është zbatuar plotësisht që nga viti 2016/2017.

Reforma e pensioneve dhe të moshuarit

Në vitin 2015, IKS ka realizuar një Anketë mbi Perceptimet dhe Qëndrimet e Qytetarëve ndaj Standardit të Jetesës dhe Mirëqenies me 1,100 të anketuar. Një pjesë e kesaj ankete iu kushtua

perceptimeve të qytetarëve për ndihmën sociale, shërbimet dhe sistemin e sigurimeve shoqërore në Kosovë. Më poshtë janë disa nga përgjigjet dhe pikëpamjet e marra:

Nëse qeveria është përgjegjëse për të ofruar një standard të pranueshëm të jetesës për të moshuarit, u konstatua se: Kosovarët janë të ndjeshëm ndaj të moshuarve. Të anketuarit në përgjithësi besojnë se qeveria është gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e standardeve të pranueshme të jetesës për të moshuarit. Ndërsa 84.5% e tyre pajtohen plotësisht se është përgjegjësia e qeverisë t'u sigurojë të moshuarve një standard të mirë jetese, 9.5% të tjerë deklarojnë se janë më shumë dakord sesa nuk pajtohen me këtë deklaratë. Vetëm 5% pretendojnë se nuk pajtohen plotësisht ose nuk pajtohen më shumë sesa pajtohen. Për këtë, 65,9% e të anketuarve e vlerësojnë standardin e jetesës së pensionistëve si 'shumë keq', 16,2% e të anketuarve deklarojnë se standardi i jetesës është 'i keq' për pensionistët. Qytetarët u pyetën edhe për minimumin e pensionit bazë për të mbuluar nevojat bazë të pensionistëve. Për këtë qëllim, 50% e të anketuarve e vendosin këtë vlerë midis 201 EUR – 300 EUR, me një shtesë prej 21.5% prej tyre e vlerësojnë atë midis 301 EUR – 500 EUR. Pothuajse 24% e qytetarëve besojnë se pensioni bazë duhet të jetë ndërmjet 101 euro – 200 euro, ndërsa vetëm 4.6% e të anketuarve besojnë se vlera minimale e pensionit bazë duhet të jetë më e lartë se 500 euro.

Duke pasur parasysh presionet e larta për buxhetin për skemat sociale, Qeveria e Kosovës ka tentuar në vitin 2015 të ndryshojë Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti. Synimi i politikës së miratuar nga qeveria (e cila nuk arriti kurrë në Kuvend) ishte heqja e pensionit bazë të Shtyllës së parë dhe rialokimi i mjeteve në Skemën e Veteranëve të Luftës. Neni 1.4 i Ligjit, i cili mund të ndryshojë, përcakton pensionin bazë të moshës – pensionin minimal të rregullt mujor që u paguhet të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, pavarësisht nëse kanë qenë të punësuar apo jo, dhe ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Mbrojtja nga rreziku i pleqërisë njihet edhe nga Karta Sociale Evropiane, e cila në nenin 23 të saj thotë se “Çdo i moshuar ka të drejtën e mbrojtjes sociale”. Kushtetuta e Kosovës njeh se të gjitha traktatet kryesore që ndajnë vlerat universale të të drejtave, janë të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë edhe Kartën Sociale Evropiane. Pensioni i pleqërisë është i vetmi pension që universalisht ndahet vetëm për qytetarët rezidentë, duke mos ua mohuar kosovarëve të pensionuar këtë të drejtë të mbrojtjes e cila është e garantuar me Kushtetutë dhe me traktate dhe dokumente ndërkombëtare, të cilave Kosova aderon.

Shpenzimet buxhetore për të gjitha programet e sigurimeve shoqërore në Kosovë janë rritur nga 3.5 përqind e PBB-së në vitin 2008 në rreth 6.3 përqind në vitin 2020, duke përbërë më shumë se 20% të shpenzimeve të buxhetit të Kosovës. Shuma e mjeteve financiare për financimin e të gjitha sistemeve pensionale, invalidore dhe kategori të luftës është mbi 400 milionë euro në vit, sipas llogaritjeve. Si rezultat i kërkesave për fillimin e programeve të reja dhe grupeve të përfituesve që kanë nevojë për rritje të shumave të përfitimeve, tendosja fiskale po rritet çdo ditë. Njohja e një reforme të tillë është parashikuar prej kohësh.

.....
Hendeku gjinor i punësimit

Pushimi i lindjes

Duke pasur parasysh informalitetin e lartë, statistikave aktuale apo pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore në Kosovë nuk mund të jenë shumë të sakta. Megjithatë, të dhënat zyrtare raportojnë të dhëna midis 12% dhe 18% që edhe në skenarin më të mirë është më e ulëta në botë dhe dukshëm më e keqe se në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Përmirësimi i situatës për gratë në tregun e punës do të kërkojë adresimin paraprak të sfidave të shumta, ndërsa ato më urgjente lidhen me reformimin e politikave, legjisllacionit dhe dispozitave të lidhura me punën. Një shembull urgjence ka të bëjë me ndikimin në politikën dhe ligjin aktual të pushimit prindëror.

Me dispozitat për pushimin e lehonisë të përcaktuara me ligjin aktual, pushimi i lehonisë është maksimumi dymbëdhjetë (12) muaj. Nga kjo shumë, ligji i detyron punëdhënësit të kompensojnë punëtorët për 70% të pagës bazë për 6 muajt e parë; tre muajt e ardhshëm mbulohen nga qeveria në masën 50% të pagës mesatare në Kosovë. Tre muajt e fundit ofrohen si leje pa pagesë për ata punonjës që dëshirojnë t'i përdorin ato.

Projektligji i ri propozon 13 muaj gjithsej me 3 muaj pushim të lehonisë që paguhet nga punëdhënësi në masën 70% të pagës bazë mujore të punëtorëve + 6 muaj që paguhet nga qeveria (nga buxheti) në masën 50% të pagës mesatare në Kosovë + 3 muaj leje prindërore pa pagesë.

Duke qenë se të gjitha studimet dhe statistikave të qeverisë tregojnë se nga mbi 30,000 lindje p/vit nën 1000 gra aplikuan për pushim të lehonisë pranë Qeverisë, gjatë periudhës së dytë 3 mujore, ne besojmë dhe duke pasur parasysh se mbi 90% e grave që punojnë nuk e gëzonin të drejtën dhe kthimin në punë pas 6 muajve të parë, dhe duke pasur parasysh se sektori privat është ende i brishtë, dhe, edhe nëse ka mundësi të akomodojë këtë dispozitë do t'ua mohojë

aksesin në pozitat e tyre grave të reja në moshë riprodhuese dhe për shkak të respektimit të Ligjit për Ushqyerje me gji,

Qeveria e re, me vendim ka vendosur të paguajë pushimin e lehonisë për 6 muajt e parë, edhe lehonave të papunësuar. Po ashtu, është në përgatitje të Ligjit të ri të punës, ku do të adresohet pushimi i lehonisë dhe ai prindëror, në tërësi.

Politikat dhe shpërndarja e Mbrojtjes Sociale

Sistemi i paqartë i mbrojtjes sociale i dizajnuar në kohën e UNMIK-ut dhe i ndikuar jo nga nevoja, por nga presionet e pabalancuara të grupeve të presionit me ndikim politik, ka marginalizuar më tej disa nga grupet tradicionalisht të cënueshme (si për shembull gratë dhe fëmijët).

Sistemi është shumë i prirur ndaj diskriminimit brenda të njëjtit grup (për shembull personat me aftësi të kufizuara të lidhura me luftën marrin mesatarisht 6 herë më shumë të ardhura nga skemat shtetërore sesa ata me aftësi të kufizuara që nuk lidhen me luftën. Një rishikim i plotë i skemave dhe rimendimi i mirëqenies shteti është një nevojë urgjente për Kosovën.

KRIZA COVID-19

Kriza e COVID-19 pati ndikime të rëndësishme negative në sistemet tashmë të dobëta shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale, si dhe ndikim social në drejtim të rritjes së varfërisë, përjashtimit, prekariatit dhe cënueshmërisë, që ka të ngjarë të jenë të rënda dhe afatgjata. Ata në rrezik më të madh nuk janë marrë gjithmonë parasysh në përgjigjen fillestare.

Kosova u siguroi përfituesve që marrin më pak se 100 euro në muaj të drejtën për 30 euro shtesë gjatë pandemisë. Gjithashtu u zgjerua mbulimi, duke përfshirë përfituesit të cilëve nuk



u ishin rinovuar të drejtat, për shkak të mos raportimit ose mosvlerësimit, në periudhën janar – mars 2020.

-Programme të reja emergjente në Kosovë, asistencë universale emergjente në para-

Në Kosovë, kompanitë që kanë regjistruar punëtorët me kontrata të paktën njëvjeçare gjatë emergjencës kanë marrë 130 euro në muaj për dy muaj pas regjistrimit. Ky program ka futur në ekonominë formale për të paktën një vit një numër të madh njerëzish nga ekonomia informale, afërsisht 15,000 persona në total.

Vlen gjithashtu të theksohet se disa programe kanë punë joformale. Në Kosovë, qeveria po thekson rëndësinë e punëtorëve joformalë dhe familjeve të tyre.

Situata Covid-19 ka rënduar më tej situatën e grave në tregun e punës. Mbyllja e shkollave, masat e izolimit dhe rritja e ngarkesës rreth familjes për shkak të kësaj situatë kanë ndikuar negativisht tek gratë e punësuar.

Sipas raportit 'Të jesh grua në tregun e punës' nga IKS dhe Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), një përqindje e konsiderueshme e grave kanë raportuar se njohin shumë kolegë që kanë humbur punën për shkak të efekteve të Covid-19 pandemia, ndërkohë që një përqindje e konsiderueshme e tyre raportojnë gjithashtu se nivelet e të ardhurave të tyre janë ulur për shkak të pandemisë.

Ndërkohë, Monitoruesi Global i Përgjigjes Gjimore i UNDP-së COVID-19 ka identifikuar 20 masa në Kosovë si përgjigje ndaj pandemisë, prej të cilave 7 janë të ndjeshme gjimore, 1 trajton kujdesin e papaguar, 5 trajton sërish dhunën ndaj grave dhe vetëm një i referohet sigurisë së ekonomisë së grave.

KERKESAT DHE ZGJIDHJA

– Buxheti i mbrojtjes sociale duhet të përdoret për të mbrojtur të varfërit në vend që të ofrojë përfitime për grupet e interesit nën presion. Në veçanti, rimendoni Ligjin e ri të propozuar për Përfitimet e Veteranëve, i cili rrezikon të kushtojë 0.8 përqind të PBB-së në vit vetëm në përfitime në para dhe mund të kushtojë dukshëm më shumë në përfitime të tjera dhe të ardhura të reduktuara tatimore; (ii) Rishpërndarja e buxhetit të mbrojtjes sociale pas një rishikimi serioz të sistemit të mbrojtjes sociale dhe rritja për të rritur mbrojtjen për të varfrit dhe të pambrojturit, me fokus te të moshuarit dhe fëmijët;

– Qeveria duhet të përmbahet nga reformimi i sistemit aktual të pensioneve;

– Qeveria duhet të nisë një sistem të identifikimit më të mirë të të varfërve dhe të pambrojturve

– Qeveria duhet të fillojë të minimizojë rrjedhjet e skemave të mbrojtjes për të pasurit;

Të anulohet rënia e shpenzimeve në skemën e ndihmës sociale dhe numri i përfituesve

REFORMA E SISTEMIT PENSIONAL – FONDI PËR SIGURIME SOCIALE:

Sistemi pensional dhe invalidor i ish Jugosllavisë së bashku me sistemin e aplikuar aktualisht në Kosovë, paraqesin problem madhor për shumicën e pensionistëve aktualë si dhe për gjeneratat tash në moshë të mesme, e në veçanti për gjeneratat e reja të punësuar pas vitit 2002. Duke ndarë vitet, periudhat e punës para vitit 1999 (shtylla e parë që menaxhohet nga MPMS) dhe asaj pas vitit 2002 (Trusti pensional apo shtylla e dytë) ka krijuar pakënaqësi tek një numër i madh i qytetarëve kosovarë, duke iu pamundësuar atyre mbrojtje të mirëfilltë sociale, përkatësisht me një rrezik që i kanoset gjeneratave të ardhshme. Dy shtyllat, janë tërësisht të ndara dhe nuk kanë ndërlidhshmëri me njëra tjetrën.

Edhe 12 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Kosovës akoma nuk ka arritur të ndërtojë një sistem bazik të sigurimeve sociale në mënyrë që qytetarët të kenë një jetë të dinjitetshme, që u garantohet edhe me Nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Që nga miratimi i Kushtetutës, asnjë Qeveri nuk e ka zbatuar Nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]



1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.
2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

SITUATA AKTUALE:

Sistemi i pensioneve të Kosovës është dizajnuar të jetë i thjeshtë dhe i qëndrueshëm në aspektin fiskal, duke siguruar mbulim adekuat për qytetarët. Disa prej **sfidave** me të cilat ballafaqohet sistemi i pensioneve dhe beneficioneve burojnë nga **korniza aktuale legjislative**, duke mundësuar përfitime **nga më shumë se një skemë**, duke **favorizuar** vetëm disa **grupe të përfituesve** dhe krijuar **presion fiskal në buxhet**.

Sidoqoftë, qëndrueshmëria fiskale dhe drejtësia e sistemit të pensioneve sot janë vënë në **rrezik**, duke shtuar skemat pensionale të pa planifikuara nga viti në vit, pa marrë parasysh ndikimin, pranueshmërinë ose nevojat aktuale **të mirëqenies së tyre**.

Vështirësitë në zbatimin e **23 skemave pensionale** nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shumësia e ligjeve të ashtuquajtura të veçanta (**13**), rritja e vazhdueshme e skemave pensionale dhe sociale, **pabarazia sociale në mes të përfituesve të kategorive të njëjta**, trajtimi **jo i barabartë** i personave me aftësi të kufizuara, janë vetëm disa nga problemet kryesore të sistemit.

Përveç këtyre problemeve, **mungesa e një sistemi të sigurimeve sociale** të bazuar në kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve, mungesa e një **ligji bazik dhe unik** që rregullon dhe menaxhon pensionet dhe beneficinet nga sigurimi social për të gjitha kategoritë, si dhe paqëndrueshmëria financiare që na prin në të ardhmen, përbëjnë arsyet kryesore të nismës së përgatitjes **së një reforme**.

Sistemi Aktual:



Shtylla e parë:

- Pensionet nga shtylla e parë së bashku me skemat e pensioneve të veçanta në Kosovë përbëjnë pjesën më të madhe të sistemit të pensioneve;
- Menaxhohen nga MPMS përmes Departamentit të Pensioneve dhe Departamentit për Familje të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës;
- 22 skemat pensionale;
- 13 ligje në fuqi;
- 250 000 përfitues me rreth 400.0 milionë euro;



Shtylla e dytë:

- Kursimet e obligueshme pensionale në llogari individuale në Fondin Pensional të Kosovës ku punëdhënësit dhe punëmarrësit kontribuojnë me minimum nga 5% të pagës;
- Pagesa e pensionimit nga shtylla e dytë nuk mund të zgjasë më shumë se 8 vjet dhe 4 muaj (100 muaj) - nuk përfitohet pension nga kjo shtyllë për sa kohë që i pensionuari është gjallë;
- Jo i liberalizuar.

OBJEKTIVA E REFORMËS:


Objektivë e përgjithshme e reformës së propozuar, është ofrimi i stabilitetit dhe garantimi për të gjithë qytetarët kosovarë që kanë nevojë për mbrojtje sociale, duke reformuar dhe modernizuar sistemin pensional dhe invalidor sipas standardeve ndërkombëtare dhe nevojave socio ekonomike të vendit.

Qëllimi është që të krijojmë një kornizë të përgjithshme ligjore dhe të qëndrueshme të sistemit pensional, invalidor dhe fushave tjera nga sigurimi social duke krijuar qëndrueshmëri dhe stabilitet financiar të vendit.



SI DO TË DUKET REFORMA:

Me zbatimin e reformës, mbrojtja sociale dhe sistemi i sigurimeve sociale ne Kosovës do të organizohet në katër shtylla: Shtylla Zero, Shtylla I, Shtylla II, dhe Shtylla III).



Risi e këtij sistemi do të jetë dizajnimi i shtyllës së parë të sistemit pensional dhe invalidor, përkatësisht **sistemit të sigurimeve sociale**, sistem ky i bazuar në kontributet e punëdhënësve dhe të punësuarve me shumë prej **3%** të pagës gjithsej ku shumta e kontributit do të jetë 1.5% nga punëdhënësi dhe 1.5% nga punëmarrësi, i cili do të jetë i ndarë nga shtylla zero apo skemat që financohen nga Buxheti i Shtetit.



Nga kjo alternativë do të krijohet shtylla e parë e cila do të menaxhohet nga Fondi për Sigurime Sociale. Me vetem 1.5% të pagës së punëtorit që do të ndahen në Fondin e Sigurimeve Sociale dhe 1.5% të punëdhënësit, do të realizohen këto të drejta/ përfitime financiare:

- pensioni i moshës gjatë tërë jetës (minimum 5 vite kontribues në shtyllën e parë),
- pensioni invalidor i punës (i plotë, i pjesshëm dhe i përkohshëm)
- pensioni familjar;
- pensioni i parakohshëm (policia, minatorët, të punësuarit me sëmundje afatgjata);
- kompensimi nga aksidentet në punë;
- kompensimi për pushimin mjekësor;
- mbrojtja prindërore/ pushimi i lehonisë dhe prindëror;
- mbrojtja nga papunësia / benefitet nga papunësia.

Fondi do të ketë në përgjegjësi menaxhimin e kontributeve të mbledhura për shtyllën e parë, përkatësisht pensionet e shtyllës së parë.



Ndërsa pjesë e shtyllës zero do të jenë:

- Pensioni bazik i moshës;
- Pensioni kontribues para vitit 1999;
- Pensioni familjar para vitit 1999;
- Pensioni invalidor para vitit 1999;
- Pensioni për aftësinë e kufizuar;
- Pensionet për kategoritë e dala nga lufta;
- Pensioni i TMK-së.

Në kuadër të kësaj shtylle do të hyjnë të gjitha skemat dhe përfitimet, të cilat do të financohen nga Buxheti i Shtetit (pjesërisht), për të cilat kriteret e përzgjedhjes së përfitueseve dhe realizimit të të drejtave janë të rregulluara me ligje të veçanta dhe do të rregullohen me legjislacionin e ardhshëm. Përfituesit e kësaj shtylle janë të gjithë përfituesit aktual dhe ata që priten të hyjnë në bazë të ri-dizajnimit të kriterëve ligjore.

CKA ËSHTË FONDI PËR SIGURIME SOCIALE?

Agjenci ekzekutive e Administratës Shtetërore në kuadër të MPMS/Qeverisë, i cili do të merret me:

- menaxhimin e buxhetit – kontributet e mbledhura nga punëdhënësi dhe i punësuar;
- administrimin e Zyrave të Pensioneve dhe Zyrave të kategorive të dalura nga lufta e UCK-së;
- zbatimin e disa skemave të pagesave dhe përfitimeve të dy shtyllave (Shtylla zero dhe Shtylla e parë) të fushës së mbrojtjes sociale.



PSE DUHET?

- ⇒ Të rrisë barazinë në mes të kategorive të ndryshme të përfituesve në aspektin e përfshirjes sociale dhe stabilitet financiar.
- ⇒ Të krijohet një sistem pensional dhe invalidor i cili është i qëndrueshëm dhe stabil, sistem ky që i plotëson nevojat e qytetarëve dhe që përcjellet me zhvillim ekonomik të vendit.
- ⇒ Reformohet dhe modernizohet sistemi pensional dhe invalidor sipas standardeve ndërkombëtare dhe nevojave socio ekonomike të vendit.
- ⇒ Të përmirësojë shërbimet/beneficionet për të moshuarit, zvogëlimin e burokracisë si dhe largimin e keqpërdoruesve potencial të skemës.



SA JANË SHPENZIMET AKTUALE TË SKEMAVE PENSIONALE?

Bazuar në trendin historik të shpenzimeve buxhetore për të gjitha skemat e mbrojtjes sociale në Kosovë, shpenzimet kanë shënuar një rritje nga 3.5 % të GDP-së në vitin 2008 në rreth 6.3 % në vitin 2020 apo në mbi 20% të shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës. Nga përlogaritja në mjete buxhetore, shumën e mjeteve financiare për mbulimin e të gjitha skemave pensionale, invalidore dhe të kategorive të luftës është mbi 400.0 milion euro në vit. Presioni fiskal për çdo ditë vazhdon të jetë në rritje si rezultat i kërkesave për fillimin e skemave të reja dhe kategorive të përfituesve që kërkojnë rritje të shumës së përfitimeve.

SA JANË SHPENZIMET PËR ZBATIMIN E REFORMËS?

Nga buxheti i shtetit për pagesat e pensioneve dhe kompensimeve nga shtylla zero dhe kontributet e paguara nga punëdhënësi për të gjithë zyrtarët publik, në vitin e parë të fillimit të zbatimit të reformës do të kërkojë financim shtesë deri në 50.0 milion euro;

- 10 milion euro - do të jetë kosto e pagesës së kontributeve nga shteti si vlerë prej 1.5% për të gjithë zyrtarët publikë;
- 10 milion euro - do të jetë kosto e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pas procesit të kategorizimit të personave me aftësi të kufizuar (shtylla zero);
- 20 milion euro - do të jetë kosto e pagesës për rritjen e pensionit bazë nga 90 euro deri 100 euro (shtylla zero/ alternative);
- 10 milion euro - do të shërbejnë për mbulimin e kostove për aksidentet në punë, benefite të papunësisë, pensionet e parakohshme, pushimi prindëror (shtylla 1, vetëm viti i parë/ alternative).

Në vitin e parë të fillimit të zbatimit të kësaj reforme, shpenzimet për mbulimin e përfitimeve të lartshënuara planifikohen të paguhen nga mjetet buxhetore të Buxheti të Kosovës.

Po ashtu në të njëjtin vit, kur planifikohet të fillon zbatimi i reformës, planifikohet të fillohet të mbliidhen kontributet në vlerë prej 3% që në total deri në fund të vitit fiskal, planifikohet të arrijë 50 milion euro .

Mjetet e mbledhura nga kontributet do të shfrytëzohen për mbulimin e skemave të shtyllës parë dhe ndonjë skemë të shtyllën zero. Me këtë nënkuptohet se që nga vitit i dytë i zbatimit të kësaj reforme do të ulen kostoja e zbatimit të reformës për shkak se shumica e implikimeve buxhetore të shtyllës së parë dhe zero do të mbuloen nga Fondi i Sigurimeve Sociale.

SI E KANË TË RREGULLUAR SHTETET E TJERA?

Të gjitha shtetet në rajon dhe në BE, e kanë të instaluar sistemin e sigurimit social.



PËRFUNDIM

- Kjo reformë dhe ky sistem, nuk është risi në aspektin e politikave sociale, por është diçka që Kosova dhe qytetarët e saj duhet të kenë, si në aspektin e plotësimit të standardeve dhe kërkesave ndërkombëtare ashtu edhe në plotësimin e nevojave bazike.
- Përfundimisht, qëllimi është që të krijohet një sistem pensional dhe invalidor i cili është i qëndrueshëm dhe stabil për shumë vite, sistem ky që i plotëson nevojat e qytetarëve dhe që përcillet nga zhvillimi ekonomik i vendit.
- Rritë formalizmin e vendeve të punës;
- Rritë shkallën e punësimit të grave në tregun e punës;
- Liron punëdhënësit nga detyrimi për pagesën e pushimit të lehonisë; dhe
- Parandalon iniciativat e reja ligjore.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet
Sylejman Vokshi,
Nr. i hyrjës 50/2
Prishtinë, Kosovë
info@iksweb.org